

Ndërmarrja Publike Qendrore
Posta e Kosovës Sh.A.

Mbështetur në Ligjin për Ndërmarrjet Publike - Ligji 03/L-087 dhe nenet 41 dhe 197 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare në Kosovë, Bordi i Drejtorëve të NPQ "Posta e Kosovës" Sh.A. në mbledhjen e mbajtur më datë 28.05.2025 sipas Vendimit nr.01-930/25 të datës 30.05.2025, miraton:

STATUTIN
E
NDËRMARRJES PUBLIKE QENDRORE "POSTA E KOSOVËS" SH.A.
PRISHTINË

Neni 1
Dispozitat e Përgjithshme

Me këtë Statut rregullohen çështjet e përgjithshme me rëndësi për statusin, organizimin dhe afarizmin e Shoqërisë Aksionare Posta e Kosovës në Prishtinë dhe atë:

- Emërtimi dhe selia;
- Themeluesit e shoqërisë;
- Aksionet;
- Veprimtaria;
- Kapitali themeltar dhe pasuria;
- Ndarja e fitimit;
- Organet e shoqërisë;
- Detyrimi për mos konkurrencë;
- Rezervat dhe pasuria;
- Të punësuarit;
- Shpërbërja e shoqërisë;
- Dispozitat përfundimtare.

Neni 2

Ndërmarrja Publike Qendrore Posta e Kosovës Sh.A. është themeluar në zbatim të Ligjit *mbi Ndërmarrjet Publike* Nr. 03/L-087 dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare Nr. 02/L-123 në Kosovë, është krijuar/themeluar si entitet legal me ndarjen e Shoqërisë Aksionare "Posta dhe Telekomit i Kosovës Sh.A." numri i regjistrimit 811285205, bazuar në vendimin e aksionarit Qeveria e Republikës së Kosovës nr. 16/53, datë 21.12.2011.

Neni 3

1. Shoqëria është person juridik, e cila në mënyrë të pavarur paraqitet dhe ka të gjitha autorizimet në marrëdhëniet juridike me personat e tretë.
2. Ky Statut, është dokumenti themelues dhe konstituiv i Shoqërisë "Posta e Kosovës ".SH.A. Ndryshimet dhe plotësimet në statut, nuk kanë efekt juridik derisa të miratohen nga aksionarët dhe të dorëzohen në Zyrën e Regjistrimit të Biznesit në përputhje me ligjin.
3. Shoqëri, duhet të nxjerre rregulloret, të cilat përmbajnë dispozita për administrimin dhe funksionimin e shoqërisë. Rregulloret miratohen, ndryshohen ose revokohen nga bordi i drejtorëve, përveç nëse këto autorizime janë rezervuar vetëm për aksionarët në statutin e shoqërisë. Asnjë rregullore e miratuar nga aksionarët nuk mund të ndryshohet ose revokohet nga bordi i drejtorëve, përveç nëse kështu është përcaktuar në rregullore.
4. Në rast konflikti, statuti i shoqërisë mbizotëron mbi rregulloret. Në raste të tilla, dispozitat përkatëse të rregulloreve konsiderohen të revokuara ose të ndryshuara në masën e nevojshme për eliminimin e mospërputhjes.

Neni 4

Në harmoni me atë, Shoqëria ka të drejtë të lidhë kontrata dhe të kryejë punë tjera juridike, si dhe të ndërmerr veprime në kuadër të aftësive të veta juridike dhe afariste.

Neni 5

Shoqëria në qarkullimin juridik paraqitet në emër dhe llogari të vet, ndërsa për veprimet e veta përgjigjet me tërë pasurinë e vet.

Neni 6

Emërtimi dhe Selia

Shoqëria vepron nën emërtimin: Ndërmarrja Publike Qendrore Posta e Kosovës Sh.A. Prishtinë.

E-maili zyrtar i ndërmarrjes është info@postakosoves.com

Neni 7

Emërtimi i shkurtë është: Posta e Kosovës Sh.A. PK Sh.A. Prishtinë.

Neni 8

1. Selia e Shoqërisë është në Prishtinë, Dardania, rruga "28 Nëntori" nr. 4.
2. Shoqëria në kuadër të saj ka edhe njësinë nr.1- Institucionin Financiar Jo Bankar me adresë në Dardani -Prishtinë.
3. Shoqëria në bazë të licencës së dhënë nga ARKEP dhe BQK, kryen shërbime në 161 zyra postare (njësi) në tërë territorin e Republikës së Kosovës:

Nr.	Zyrat Postare (njësit)	Komuna	Adresa	Kodi i veprimtarisë
	Njësi nr.1- Institucionin Financiar Jo Bankar	Prishtinë	Dardani -Prishtinë.	6419
1	Zyra Postare Prishtina 01	Prishtinë	Rr."Agim Ramadani" p.n.	5310
2	Zyra postare Prishtina 02 - Qafa	Prishtinë	Rr."UQK- se" nr. 246	5310
3	Zyra postare Prishtina 03	Prishtinë	Rr."Lidhja e Pejës" , Hyrja 1	5310
4	Zyra postare Prishtina 05	Prishtinë	Rr."Bulevardi Nëna Tereze	5310
5	Zyra postare Prishtina 06	Prishtinë	Rr."Ramiz Sadiku" p.n.	5310
6	Zyra postare Prishtina 07	Prishtinë	Rr. " Luan Haradinaj" p.n. Objekti i MPB Divizioni për të huaj	5310
7	Zyra postare Prishtina 09	Prishtinë	Sheshi Bill Clinton	5310
8	Zyra postare Prishtina 10	Prishtinë	Dardani p.n.	5310
9	Zyra postare Prishtina 11	Prishtinë	Kodra e Diellit p.n.	5310
10	Zyra postare Prishtina 12	Prishtinë	Qendra spitalore	5310
11	Zyra postare Prishtina 13	Prishtinë	Rr."Luan Haradinaj" (MPB) Objekti i ARC-së	5310
12	Zyra postare Prishtina 14	Prishtinë	Rr."Ukshin Hoti" nr.39	5310
13	Zyra postare Prishtina 15	Prishtinë	Stacioni Qendror i Autobusëve	5310
14	Zyra postare Prishtina 17	Prishtinë	Rr. "Ukshin Hoti " p.n në ish objektin e Rilindjes	5310
15	Zyra postare Prishtina 18	Prishtinë	Rr. " Arbënor dhe Astrit Dehari " p.n.	5310

16	Zyra postare Prishtina 19	Prishtinë	Rr."Ilir Konushevc" Objekti i Qendrës për të moshuar p.n.	5310
17	Zyra postare Prishtina 21 - QTP	Prishtinë	Zona Industriale	5310
18	Zyra postare Prishtina 22- Iliria	Prishtinë	Rr. " Tring Samjli" p.n.	5310
19	Zyra postare Prishtina 23	Prishtinë	Pallati i Drejtësisë	5310
20	Zyra postare Prishtina 24	Prishtinë	Rr. "Nazmi Gafuri" p.n.	5310
21	Zyra postare Prishtina 27 KK	Prishtinë	Objekti Komuna e Vjetër	5310
22	Zyra postare Prishtina 28	Prishtinë	Rr. "Ahmet Krasniqi" p.n. Objekti i ri KK	5310
23	Zyra postare Hajvali	Prishtinë	Fshati Hajvali	5310
24	Zyra postare Bardhosh	Prishtinë	Fshati Bardhosh p.n.	5310
25	Zyra postare Besianë	Besianë	Rr. "Zahir Pajaziti" p.n.	5310
26	Zyra postare Besiana 02	Besianë	Rr. "Ilir Konushevc" Objekti i ri i ARC	5310
27	Zyra postare Besiana 03	Besianë	Rr. "Nuhi Gashi" (K.K Besianë)	5310
28	Zyra postare Lluzhan	Besianë	Fshati Lluzhan p.n.	5310
29	Zyra postare Orllan	Besianë	Fshati Orllan p.n.	5310
30	Zyra postare Kërpimëh	Besianë	Fshati Kërpimëh p.n.	5310
31	Zyra postare Kastriot	Kastriot	Sheshi Skënderbeut p.n.	5310
32	Zyra postare Kastriot_02	Kastriot	Objekti i ARC-së	5310
33	Zyra postare Muzakaj	Kastriot	Fshati Muzakaj p.n.	5310
34	Zyra postare Fushë Kosovë 01	Fushë Kosovë	Rr. "Nëna Terezë" p.n. (MPB)	5310
35	Zyra postare Fushë Kosovë 02	Fushë Kosovë	Rr. "Dardania" nr. 13 objekti i ujësjellësit KRU/PR	5310
36	Zyra postare Fushë Kosovë 03	Fushë Kosovë	Rr. Dardania	5310
37	Zyra postare Bardhi i Madh	Fushë Kosovë	Fshati Bardhi i Madh p.n.	5310
38	Zyra postare Sllatinë e Madhe	Fushë Kosovë	Fshati Sllatinë e Madhe p.n.	5310
39	Zyra postare Drenasi	Drenas	Rr. "Fehmi dhe Xhevë Lladrovci " p.n.	5310

40	Zyra postare Drenas_02	Drenas	Rr." Besim Mala" p.n. (Objekti i ARC)	5310
41	Zyra postare Drenas_03	Drenas	Objekti i Gjykatës Themelore Drenas	5310
42	Zyra postare Bushati	Drenas	Fshati Bushat p.n.	5310
43	Zyra postare Lipjani	Lipjan	Rr. "Adem Jashari" p.n.	5310
44	Zyra postare Lipjani 2	Lipjan	Objekti I MPB-së Sheshi " Adem Jashari" p.n.	5310
45	Zyra postare Janjeva	Lipjan	Fshati Janjevë p.n.	5310
46	Zyra postare Graçanicë	Graçanicë	Graçanicë p.n.	5310
47	Zyra postare Graçanicë 02	Graçanicë	Rr. "Car Lazar" p.n	5310
48	Zyra postare Magure	Lipjan	Fshati Magure	5310
49	Zyra postare Prizren 1	Prizren	Rr. "Adem Jashari" p.n.	5310
50	Zyra postare Prizren 2	Prizren	Rr. "Shkronjave" p.n.	5310
51	Zyra postare Prizren 3	Prizren	Rr. "De Radës" p.n.	5310
52	Zyra postare Prizren 4	Prizren	Rr." Ismet Jashari Kumanova" p.n.	5310
53	Zyra postare Prizren 5	Prizren	Rr. "272 Qazim Berisha "	5310
54	Zyra postare Prizren 6	Prizren	Rr." 103 Jusuf Gërvalla "	5310
55	Zyra postare Prizren 7	Prizren	Wiliam Wolkerp.n , Prizren	5310
56	Zyra postare Prizren 9	Prizren	Rr. "Wiliam Wolker" p.n. (MPB)	5310
57	Zyra postare Prizren 10	Prizren	Rr. "Remzi Ademi" p.n. (KK)	5310
58	Zyra postare Zhur	Prizren	Fshati Zhur p.n.	5310
59	Zyra postare Reçan	Prizren	Fshati Reçan p.n.	5310
60	Zyra postare Mamushë	Prizren	Fshati Mamushë p.n.	5310
61	Zyra postare Korishë	Prizren	Fshati Korishë p.n.	5310
62	Zyra postare Malishevë 1	Malishevë	Rr. "Gjergj Kastrioti-Skënderbeu" p.n.	5310
63	Zyra postare Malishevë 2	Malishevë	Rr. "Adem Jashari" (MPB)	5310
64	Zyra postare Malisheva 3	Malishevë	Rr. "Gjergj Kastrioti" p.n. (KK)	5310

65	Zyra postare Banja e Madhe	Malishevë	Fshati Banja e Madhe p.n.	5310
66	Zyra postare Kijevë	Malishevë	Fshati Kijevë p.n.	5310
67	Zyra postare Rahoveci 1	Rahoveci	Rr. "Xhelal Hajda"- Toni p.n.	5310
68	Zyra postare Rahoveci 2	Rahoveci	Rr. "486 Xhelal Hajda"- Toni (KK)	5310
69	Zyra postare Rahoveci 3	Rahoveci	Rr. "Sheh Myhedini "p.n. (MPB)	5310
70	Zyra postare Ratkoc	Rahoveci	Fshati Ratkoc p.n.	5310
71	Zyra postare Suharekë 1	Suharekë	Rr." 560 Brigada 123"	5310
72	Zyra postare Suharekë 2	Suharekë	Rr. "560 Brigada 123" (MPB)	5310
73	Zyra postare Suharekë 3	Suharekë	Rr. "561 Brigada 123" KK	5310
74	Zyra postare Samadraxhë	Suharekë	Fshati Samadraxhë p.n.	5310
75	Zyra postare Duhël	Suharekë	Fshati Duhël p.n.	5310
76	Zyra postare Dragash	Dragash	Rr." 480 Rruga e Dëshmorëve"	5310
77	Zyra postare Bresanë	Dragash	Fshati Bresanë p.n.	5310
78	Zyra postare Bellobrad	Dragash	Fshati Bellobrad p.n.	5310
79	Zyra postare Brod	Dragash	Fshati Brod p.n.	5310
80	Zyra postare Krush e Madhe	Rahovec	Fshati Krush e Madhe	5310
81	Zyra postare Mitrovica 1	Mitrovicë	Rr. "Afrim Zhitia" p.n.	5310
82	Zyra postare Mitrovica 2	Mitrovicë	Rr. "Mbreti Peteri" nr.20	5310
83	Zyra postare Mitrovicë 3	Mitrovicë	Rr. "Agim Ramadani" p.n. (MPB)	5310
84	Zyra postare Mitrovicë 4	Mitrovicë	Rr. "Nemanjina" p.n.	5310
85	Zyra postare Mitrovica Veriore 5	Mitrovicë	Rr.Çlirimi p.n. (MPB-ARC)	5310
86	Zyra postare Mitrovica 6	Mitrovicë	Rr. "Brigada 141" p.n.	5310
87	Zyra postare Mitrovica 9	Mitrovicë	Kuvendi Komunal Mitrovicë	5310
88	Zyra postare Shipol	Mitrovicë	Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.	5310
89	Zyra postare Vushtrri	Vushtrri	Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.	5310
90	Zyra postare Vushtrri 2	Vushtrri	Rr. Nexhip dhe Ferat Dragaj p.n.	5310
91	Zyra postare Vushtrri 3	Vushtrri	Rr. "Hamit Hyseni "p.n. MPB	5310

92	Zyra postare Skenderaj	Skenderaj	Rr. "Sheshi Adem Jashari" p.n.	5310
93	Zyra postare Skenderaj 2	Skenderaj	Rr. "18 Qershori"(KK)	5310
94	Zyra postare Skenderaj 3	Skenderaj	Rr." 18 Qershori "(MPB)	5310
95	Zyra postare Prekaz	Skenderaj	Rr." Bulevardi ADEM JASHARI"	5310
96	Zyra postare Runik	Skenderaj	Rr." Ahmet Kapllani" P.N.	5310
97	Zyra postare Banjskë	Zveçan	Fshati Banjska	5310
98	Zyra postare Zveçan	Zveçan	Rr."Mbreti Milutin" (st. Policor)	5310
99	Zyra postare Leposaviq	Leposaviq	Rr. Ushtria e Jugosllavisë"	5310
100	Zyra postare Zubin Potok	Zubin Potok	Rr. "Kolasinskih Knezava" p.n	5310
101	Zyra postare Bërnjak	Zubin Potok	Pika Kufitare Bërnjak	5310
102	Zyra postare Jarinje	Leposaviq	Pika Kufitare Jarinje	5310
103	Zyra postare Soçanicë	Leposaviq	Rr, Vëllzërit Radovanoviç p.n.	5310
104	Zyra postare Zveçan 2	Zveçan	Rr.Mbreti Milutin p.n	5310
105	Zyra postare Zubin Potok 2	Zubin Potok	Rr. Kolasinskih Knezeva p.n	5310
106	Zyra postare Peja 1	Pejë	Rr. "Mbretëresha Teut" nr. 63	5310
107	Zyra postare Peja 2	Pejë	Rr. Adem Jashari	5310
108	Zyra postare Peja 3	Pejë	Rr. "Sali Gjuka"	5310
109	Zyra postare Peja 4	Pejë	Rr. "Eliot Engel" (MI& QRA)	5310
110	Zyra postare Peja 5	Pejë	Rr. "TMK-së"	5310
111	Zyra postare Peja 8	Pejë	Rr. "Vëllzërit Gërvalla"	5310
112	Zyra postare Vitomerica	Pejë	Fshati Vitomericë	5310
113	Zyra postare Klinë	Klinë	Rr. "Abedin Rexha" p.n.	5310
114	Zyra postare Istog	Istog	Rr." 2 Korriku" p.n.	5310
115	Zyra postare Gurrakoc	Istog	Qendra Gurrakoc	5310
116	Zyra postare Banja e Pejës	Istog	Banjë e Pejës	5310
117	Zyra postare Istog	Istog	Rr." Fadil Ferati nr.180" (MPB)	5310
118	Zyra postare Klina	Klinë	Rr. "Drini i Bardhë" p.n. (MPB)	5310
119	Zyra postare Gjakova 1	Gjakovë	Rr. "UÇK"	5310

120	Zyra postare Gjakova 2	Gjakovë	Rr."Kolë Lleshi "p.n. (MI)	5310
121	Zyra postare Gjakova 3	Gjakovë	Rr. "Tirana" p.n. (MPB)	5310
122	Zyra postare Gjakova 4	Gjakovë	Rr. "Skënderbeu"	5310
123	Zyra postare Gjakova 5	Gjakovë	Rr. "Tirana" p.n. (Gjykata Themelore)	5310
124	Zyra postare Gjakova 6	Gjakovë	Sheshi Agron Rama	5310
125	Zyra postare Gjakova 9	Gjakovë	Rr." Dëshmorët e Lirisë"	5310
126	Zyra postare Rugovë	Gjakovë	Fshati Rugovë	5310
127	Zyra postare Deçan	Deçan	Rr. "Sheshi Mentor Tolaj"	5310
128	Zyra postare Deçani 3	Deçan	Rr. "Dëshmorët e Kombit "(MPB)	5310
129	Zyra postare Junik	Junik	Junik	5310
130	Zyra postare Gjilan 1	Gjilan	Rr. "Adem Jashari" p.n.	5310
131	Zyra postare Gjilan 2	Gjilan	Rr. "Isa Boletini" nr.6	5310
132	Zyra postare Gjilan 3	Gjilan	Rr. Lufta e Gjilanit 44 (Gjykata Themelore)	5310
133	Zyra postare Gjilan 4	Gjilan	Rr." Isa Boletini" nr.45 (MI)	5310
134	Zyra postare Gjilan 5	Gjilan	Rr." Bulevardi i Pavarësisë" nr.94 (KK)	5310
135	Zyra postare Gjilan 6	Gjilan	Rr." Lufta e Gjilanit" 44 nr. 26 (MPB)	5310
136	Zyra postare Gjilan 7	Gjilan	Rr. Ali Hadri nr.49	5310
137	Zyra postare Zhegër	Gjilan	Fshati Zhegër	5310
138	Zyra postare Viti	Viti	Rr. "Adem Jashari" p.n.	5310
139	Zyra postare Pozharan	Viti	Fshati Pozharan	5310
140	Zyra postare Kamenicë	Kamenicë	Rr. "Skënderbeu" p.n.	5310
141	Zyra postare Kamenicë 2	Kamenicë	Rr. "Skënderbeu" p.n. (KK)	5310
142	Zyra postare Hogosht	Kamenicë	Fshati Hogosht	5310
143	Zyra postare Artanë	Artanë	Fshati i Artanës p.n.	5310
144	Zyra postare Vitia 2	Viti	Rr. "28 Nëntori " p.n. (MPB)	5310
145	Zyra postare Kamenica 3	Kamenicë	Rr. "Vëllezërit Bytyqi "nr.15 (MPB)	5310
146	Zyra postare Ferizaj 1	Ferizaj	Rr." Dëshmorët e Kombit" p.n.	5310
147	Zyra postare Ferizaj 2	Ferizaj	Rr. "Cen Dugolli" p.n.(MI)	5310

148	Zyra postare Ferizaj 3	Ferizaj	Rr. "Besim Rexhepi" p.n.	5310
149	Zyra postare Ferizaj 4	Ferizaj	Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.	5310
150	Zyra postare Ferizaj 5	Ferizaj	Rr. "Vëllezërit Gërvalla" nr.81	5310
151	Zyra postare Ferizaj 7	Ferizaj	Rr."Sali Çeku" p.n. (QRA/MPB)	5310
152	Zyra postare Ferizaj 8	Ferizaj	Rr." Reçakut" p.n. (MPB)	5310
153	Zyra postare Ferizaj 9	Ferizaj	Rr."Sali Çek" p.n. (Gjykata Themelore)	5310
154	Zyra postare Kaçanik	Kaçanik	Rr. "Rruga e UÇK-së" nr.68	5310
155	Zyra postare Kaçanik 2	Kaçanik	Rr. "Qamil Ilazi" nr.40 MPB/QPD	5310
156	Zyra postare Doganaj	Kaçanik	Rr. "Ahmet Kaçiku" nr.98 Fshati Doganaj	5310
157	Zyra postare Shtërpçë	Shtërpçë	Shtërpçë afër objektit të KK	5310
158	Zyra postare Hani i Elezit	Hani i Elezit	Rr. "Dëshmorët e Kombit "nr.45	5310
159	Zyra postare Shtime	Shtime	Rr. "Ahmet Shtimja" nr.36	5310
160	Zyra postare Shtime 2	Shtime	Rr. "Isa Boletini" nr.25 (MPB/QRA)	5310
161	Zyra postare Babush	Ferizaj	Fshati Babush	5310

Personi i autorizuar i kësaj shoqërie tregtare është Kryeshefi Ekzekutiv, i cili është person i ligjshëm për pranimin e shërbimeve, njoftimeve, kërkesave, si dhe akteve tjera që dërgohen nga autoritetet publike.

Neni 9 Themeluesit e Shoqërisë

Themeluesi i shoqërisë është Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 10 Aksionet

Aksioni është tërësi e të gjitha të drejtave dhe obligimeve që i takojnë një anëtar të Shoqërisë bazuar në kapitalin fillestar.

1. Shoqëria do të ketë listën e aksionarëve.

2. Aksionet janë të formës nominale, të thjeshtë ose të privilegjuar, të certifikuara ose të pa certifikuara, të letrave me vlerë, si dhe lirisht të transferueshme sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës, i cili rregullon marrëdhëniet tregtare.

3. Vlera e aksionit të thjeshtë të shoqërisë është: 1,00 Euro (një/00 Euro).

4. Pronësia mbi aksionet rezulton nga regjistrimi i tyre në emër të pronarit, në librin e aksioneve të mbajtur nga ana e shoqërisë apo ndërmjetësve financiarë.

Neni 11

Lartësia e Aksioneve

Aksionet e shoqërisë zotërohen në masën 100% nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 12

Libri (Regjistri) i Aksioneve

Librin e aksioneve e mban në masën 100% Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni13

Disponimi me Aksione

1. Regjistri i Aksionarëve

1.1. Kompania duhet të themelojë dhe të mirëmbajë Regjistrin e Aksionarëve, në pajtueshmëri me ligjin. Regjistrat e tillë duhet të përmbajnë informatat e kërkuara në bazë të ligjit, si dhe çfarëdo informatë tjetër që kompania mendon se është e nevojshme.

1.2. Kompania nuk do t'i ngarkojë me taksë për regjistrimin e çfarëdo transferi apo dokumenti tjetër në lidhshmëri me/apo, i cili dëmton titullin e ndonjë aksioni.

1.3. Sekretari mund të regjistrojë transferin e ndonjë aksioni vetëm kur t'i ofrohet dëshmia mbi transferin në pajtueshmëri me ligjin.

1.4. Sekretari duhet të lejojë aksionarët, të tjerët të aprovuar me ligj, si dhe agjentët e tyre relevant të autorizuar të shikojnë regjistrin e aksionarëve dhe duhet të ju ofrojë atyre ekstrakte (fragmente) relevante nga regjistri sipas kërkesës së tyre.

2. Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve

Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve të Kompanisë ("Mbledhja e Përgjithshme") është trupi më i lartë vendim-prurës i kompanisë. Vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme, të cilat konsiderohen vendime, duhet të jenë detyruese për kompaninë, aksionarët, trupat e tjerë, si dhe zyrtarët e kompanisë.

3. Thirrja dhe Agjenda e Mbledhjes së Përgjithshme

3.1. Kompania duhet të mbajë një mbledhje të përgjithshme vjetore ("*Mbledhja e Përgjithshme Vjetore*") që të rishikohen dhe të aprovohen pasqyrat financiare vjetore, brenda njëqind e pesëdhjetë (150) ditëve pas mbylljes së vitit financiar të kompanisë.

3.2. Mbledhjet e përgjithshme thirren nga udhëheqësi i Bordit të Drejtorëve, duke vepruar përmes sekretarit.

3.3. Mbledhjet e përgjithshme mund të thirren nga Bordi i Drejtorëve kurdo që të paraqitet nevoja; në mënyrë të barabartë Bordi i Drejtorëve mund të përfshijë çështjet shtesë në agjendën e Mbledhjes së Përgjithshme Vjetore.

3.4. Dy apo më tepër anëtarë të Bordit të Drejtorëve, apo aksionarëve në posedim të jo më pak se njëzet për qind (20%) të aksioneve të lëshuara apo votimit në pritje të kompanisë, mund të kërkojnë mbajtjen e Mbledhjes së Përgjithshme, duke përfshirë agjendën. Një kërkesë e tillë duhet t'i bëhet me shkrim udhëheqësit të Bordit të Drejtorëve dhe duhet të aprovohet kurdo që çështjet e propozuara bien përbrenda kompetencave të Mbledhjes së Përgjithshme. Udhëheqësi i Bordit të Drejtorëve duhet ta thërret Mbledhjen e Përgjithshme për një datë jo më vonë se katërdhjetë (40) ditë pasi ta ketë kanë pranuar kërkesën, përveç nëse kërkesa përcakton një datë më të vonshme.

3.5. Sipas rregullave të përcaktuara, çështjet shtesë, mund të përfshihen në agjendën e Mbledhjes së Përgjithshme Vjetore; një kërkesë e tillë mund të mos përfillet në rast se dorëzohet jo më vonë se njëqind (100) ditë pas mbylljes të vitit financiar të kompanisë. Nëse një kërkesë e tillë bëhet pasi të jetë dërguar njoftimi për mbledhje, Mbledhja e Përgjithshme Vjetore duhet të shtyhet dhe duhet të dërgohet njoftimi i ri, duke përfshirë edhe çështjet shtesë të agjendës.

4. Njoftimi i Mbledhjes së Përgjithshme dhe Procedimet

4.1. Njoftimi për një Mbledhje të Përgjithshme duhet t'i dërgohet secilit aksionar së paku tridhjetë (30) ditë më herët në adresat e listuara për secilin aksionar në regjistrin e aksionarëve, si dhe secilit anëtar të Bordit të Drejtorëve. Për më tepër, njoftimi duhet të bëhet përmes publikimit ashtu siç kërkohet me ligj.

4.2. Njoftimi duhet të përfshijë kohën dhe vendin e Mbledhjes së Përgjithshme dhe agjendën. Njoftimi duhet të njoftojë se, nëse ndonjë palë nuk do të jetë prezent në Mbledhjen e Përgjithshme, atëherë kjo e fundit mund të shtyhet për më vonë për ndonjë datë më të përshtatshme, duke përcaktuar kohën dhe vendin: një datë e tillë nuk mund të jetë më herët se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas datës origjinale për mbledhjen, e as tridhjetë (30) ditë pas saj.

4.3. Dështimi për ta njoftuar secilin aksionar për Mbledhjen e Përgjithshme mund të eliminohet nëse ai person merr pjesë në Mbledhjen e Përgjithshme personalisht apo i autorizuari i tij. Dështimi për ta njoftuar për Mbledhjen e Përgjithshme secilin anëtar të Bordit të Drejtorëve mund të eliminohet nëse shumica e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve marrin pjesë në Mbledhjen e Përgjithshme personalisht.

4.4. Secila kërkesë për njoftim do të konsiderohet jo e vlefshme nëse Mbledhja e Përgjithshme vepron sipas vendimit të shkruar dhe nëse është e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e pranishëm.

4.5. Mbledhjet e Përgjithshme mund të mbahen në më tepër se një lokacion përmes lidhjes së ndërsjellë me zë apo video-konferencë, përderisa kërkesat në vijim plotësohen dhe reflektohen në procesverbalet relevante.

4.6 Udhëheqësi i Mbledhjes së Përgjithshme duhet të jetë në gjendje të përcaktojë identitetin dhe të drejtën e participimit të atyre që janë prezent, duhet të udhëheqë Mbledhjen e Përgjithshme, dhe duhet të përcaktojë dhe të deklarojë rezultatet e votimit;

4.7 Sekretari i Mbledhjes së Përgjithshme duhet të jetë në gjendje që në mënyrë adekuate t'i perceptojë ndodhitë në Mbledhjen e Përgjithshme, dhe

4.8 Pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në diskutime dhe të votojnë për pikat e agjendës, gjithashtu të lexojnë, të pranojnë apo të dërgojnë dokumentet e ndërlidhura (nëse ka ndonjë).

5. Kuorumi për Mbledhjet e Përgjithshme

5.1. Mbledhja e Përgjithshme mund të mbahet vetëm nëse kuorumi është prezent personalisht apo përmes të të autorizuarit. Sekretari duhet të kryejë aranzhimet e nevojshme që aksionarët të regjistrojnë aksionet e tyre në Mbledhjen e Përgjithshme. Kuorumi duhet të jetë prezent nëse aksionarët (apo agjentët e tyre të autorizuar) duke përfaqësuar së paku pesëdhjetë (50%) për qind të aksioneve votues të kompanisë, janë të regjistruar si prezent në Mbledhjen e Përgjithshme.

5.2. Nëse nuk ka kuorum përbrenda një periudhe të arsyeshme kohore pas kohës së përcaktuar për fillim, Mbledhja e Përgjithshme duhet të ndërpritet apo të shtyhet për një datë të përshtatshme që është e përcaktuar në njoftim (nëse ka). Që një Mbledhje e tillë e Përgjithshme të shtyhet, kuorumi duhet të jetë njëzet e pesë për qind (25%) e pjesës votuese të kompanisë. Nëse, në Mbledhjen e Përgjithshme të shtyrë, nuk ka kuorum brenda një periudhe të arsyeshme kohore pasi mbledhja të ketë filluar, Mbledhja e Përgjithshme do të anulohet.

6. Udhëheqësi i Mbledhjes së Përgjithshme

Udhëheqësi i Bordit të Drejtorëve apo, me vendim të aksionarëve, personi i zgjedhur nga shumica e pjesës së prezantuar në Mbledhjen e Përgjithshme, duhet të jetë Udhëheqësi i Mbledhjes së Përgjithshme. Udhëheqësi i Mbledhjes së Përgjithshme duhet që duke vepruar arsyeshëm dhe në pajtueshmëri me ligjin dhe këto statute, të konstatojë prezencën e kuoromit, të drejtojë debatin dhe të mbajë procesverbalin, si dhe të konstatojë e deklarojë rezultatet e votimit: Sekretari do të asistojë udhëheqësin.

7. Votat e aksionarëve

7.1. Secili aksionar, emri i të cilit paraqitet në regjistrin e aksionarëve tridhjetë (30) ditë më herët nga data në të cilën është thirrur Mbledhja e Përgjithshme, duhet të ketë një votë për secilin aksion për të cilin ai është mbajtës i regjistruar në regjistrin e aksionarëve të kompanisë.

7.2. Secili i aksionar i autorizuar do të emërohet me shkrim nga aksionari i caktuar dhe duhet të pranohet nga Sekretari para fillimit të Mbledhjes së Përgjithshme.

7.3. Vota e dhënë nga i autorizuari duhet të jetë e vlefshme, pa marrë parasysh shkarkimin e mëhershëm të autoritetit të personit votues, përveç nëse njoftimi për shkarkim, është pranuar nga Sekretari para fillimit të mbajtjes së Mbledhjes së Përgjithshme ku edhe është dhënë vota.

7.4. Një vendim i vënë në votim në Mbledhjen e Përgjithshme duhet të vendoset nga numërimi publik. Numërimi duhet të fillojë menjëherë kur udhëheqësi i Mbledhjes së Përgjithshme udhëzon në atë mënyrë që mundëson votimet që i përkasin secilit aksion “për” apo “kundër” vendimit, që të numërohet në mënyrë të saktë. Në rast se ka votim të barabartë, udhëheqësi i Mbledhjes së Përgjithshme (nëse ai apo ajo është aksionar) mund të ketë votë vendimtare.

7.5. Mbledhja e Përgjithshme mund të miratojë vetëm vendimet në lidhje me çështjet, të cilat janë përmbledhur në agjendë për ndonjë Mbledhje të veçantë të Përgjithshme, përveç nëse aksionarët, të cilët përfaqësojnë të gjitha aksionet e kompanisë e të cilët kanë të drejtë të votojnë, janë prezent dhe pajtohen ndryshe.

7.6. Vendimi me shkrim, i nënshkruar nga të gjithë aksionarët e kompanisë, do të ketë të njëjtën fuqi sikurse edhe vendimi që ka kaluar në Mbledhjen e Përgjithshme që është thirrur dhe mbajtur. Çfarëdo vendimi i tillë mund të përbëhet prej disa dokumenteve duke pasur formë dhe përmbajtje identike, secili i nënshkruar nga një ose më tepër aksionarë.

8. Kompetencat e Mbledhjes së Përgjithshme

8.1. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në ligj, Mbledhja e Përgjithshme duhet të ketë kompetenca ekskluzive:

8.1.1. Të ndryshojë Statutin dhe aktet ligjore të kompanisë, si dhe të miratojë kodet e qeverisjes së përbashkët të kompanisë, të cilat duhet të përcaktojnë kriteret që duhet të drejtojnë ushtrimin nga trupat e kompanisë, të merr vendime që iu lejohet atyre nga ky statut dhe nga ligji;

8.1.2. Të ngritët apo zvogëlohet kapitali i aksioneve të kompanisë;

8.1.3. Të themelojë shtresa të ndryshme të aksioneve, të përcaktojë të drejtat e tyre dhe tiparet e tjera, si dhe t’i ndryshojë ato;

8.1.4. Të vendosë për ndonjë bashkim, konsolidim, ndarje, shpërndarje, likuidim, transformim, dhe deri në atë masë të lejuar me ligj – në bankrotim apo insolvencë (paaftësi paguese) të kompanisë;

8.1.5. Të vendosë për lëshimin e aksioneve, lëshimin e borxhit apo sigurimeve të konvertuara në aksione, si dhe konsolidimin apo ndarjen e aksioneve të papaguara dhe sigurimeve konvertuese;

8.1.6. Të emërojë, largojë apo zëvendësojë anëtarët e Bordit të Drejtorëve, si dhe të përcaktojë pagesën e tyre;

8.1.7. Të përcaktojë pagesat shtesë për ata drejtorë, të cilët gjithashtu janë anëtarë të Komisionit të Auditimit;

8.1.8. Të emërojë, me propozim të Komisionit të Auditimit, të largojë apo zëvendësojë auditorët e jashtëm të kompanisë, si dhe të përcaktojë pagesat e tyre (përherë në pajtueshmëri me cilindo ligj të prokurimit, i cili mund të jetë në fuqi);

8.1.9. Të autorizojë çfarëdo transaksioni në mes të kompanisë dhe cilitdo drejtor, si dhe ofrimin e çfarëdo shërbimi për kompaninë nga auditorët e saj të jashtëm, përveç shërbimit të auditimit të ofruar me këtë Statut.

8.1.10. Të aprovojë pasqyrat financiare vjetore, si dhe dokumentet e tjera të parapara, të deklarojë të gjithë dividendin dhe të vendos në mbulimin e çfarëdo humbjeje.

8.2. Vendimet duhet të kërkojnë votën pohuese të shumicës së aksioneve të lëshuara dhe të papaguara të shoqërisë. Megjithatë, çfarëdo ndryshimi kërkon votën pohuese të së paku dy të tretave (2/3) të aksioneve të lëshuara dhe të papaguara të kompanisë.

8.3. Vendimet kërkojnë votën pohuese të së paku dy të tretave (2/3) të aksioneve të lëshuara dhe të papaguara, të përfaqësuara në Mbledhjet e Përgjithshme përkatëse.

8.4. Vendimet, që nuk referohen më lartë, duhet të kërkojnë votën pohuese të shumicës së aksioneve të përfaqësuara në Mbledhjet e Përgjithshme përkatëse.

8.5. Aprovimi i transaksioneve, dokumenteve dhe akteve të tjera, nuk do t'i lirojë drejtorët dhe zyrtarët e kompanisë nga çfarëdo përgjegjësie që rezulton nga shkeljet e detyrave të tyre, të cilat u janë besuar apo nga detyrime të tjera që ka kompania, e as nuk do të nënkuptojë heqje dorë nga të drejtat dhe kompensimi të cilat kompania, mund të ketë kundër tyre në lidhje me këtë.

Neni 14

Veprimtaria e Shoqërisë

1. Shoqëria kryen veprimtarinë si në vijim:

Aktiviteti kryesor i biznesit -

5310 - Aktivitetet e postave me detyrën e shërbimit të përgjithshëm.

Aktivitetet tjera:

9609 - Aktivitetet tjera p.k.t.;

4941 - Transporti rrugor i mallrave;

5210 - Magazinimi dhe ruajtja;

5224 - Trajtimi i transportit "Cargo" ;

5229 - Aktivitetet tjera mbështetëse të transportit;

5221 - Aktivitetet shërbyese të rastit për transportin tokësor;

5829 - Publikimi i softuerëve të tjerë;

6209 - Teknologjia tjetër informative dhe aktivitetet shërbyese kompjuterike;

6419 - Ndërmjetësimet e tjera monetare;

6499 - Aktivitetet e tjera shërbyese financiare, përveç fondit të sigurimit dhe atij pensional p.k.t.;

6619 - Aktivitet e tjera ndihmëse për shërbimet financiare, përveç financimit të sigurimit dhe fondeve pensionale;

7112 - Aktivitetet e inxhinierisë dhe këshillim teknik;
8299 - Aktivitetet tjera shërbyese në mbështetje të bizneseve p.k.t.

2. Shoqëria mund të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar, i cili lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

3. Shoqëria do të kryejë çdo veprim me qëllim marrjen e lejeve, autorizimeve, licencave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarive të saj, për të cilat kërkohen këto dokumente administrative.

Neni 15

Shoqëria ka të drejtë që në kuadër të veprimtarisë së regjistruar të kryejë edhe punët e qarkullimit të jashtëm tregtar.

Neni 16

Kapitali Themeltar dhe Pasuria e Shoqërisë

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është monetar, në shumë prej 525,000.00 Euro (pesëqindnjëzet e pesëmijë).

Themeluesi ka të drejtë në kthimin e kapitalit të deponuar në Shoqëri në rast të ndërprerjes së punës së Shoqërisë, si dhe në rastet tjera të përcaktuara me ligj dhe aktet e përgjithshme të Shoqërisë.

Neni 17

Rritja e Kapitalit Themeltar

Kapitali themeltar mund të rritet me pagesën e aksioneve të reja apo rritjen e ekzistueseve, por edhe me deponimin e sendeve dhe të drejtave ose rezervës dhe fitimit të Shoqërisë në kapitalin themelor sipas Ligjit nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare.

Neni 18

Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

Kapitali themeltar mund të zvogëlohet vetëm në bazë të vendimit të aksionarit të Shoqërisë mbi ndryshimin e këtij Statuti.

Neni 19

Ndarja e fitimit dhe mënyra bartjes së rreziqeve dhe mbulimi i humbjeve

Fitimi i Shoqërisë përcaktohet në fund të vitit afarist, me të cilin nënkuptohet viti kalendarik, e në pajtim me dispozitat në fuqi të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare, si dhe ato të përcaktuara me aktet e përgjithshme të Shoqërisë.

Neni 20

Fitimin e Shoqërisë e përcakton Bordi i Drejtorëve sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike, ashtu që nga rezultatet afariste të Shoqërisë në një vit afarist kryen largimin e të gjitha shpenzimeve afariste, duke përfshirë edhe të gjitha të ardhurat e punëmarrësve, si dhe pagesat tjera sipas bazës së kontributeve, tatimeve dhe obligimeve tjera fiskale.

Ndarja e fitimit realizohet pas aprovimit të llogarisë përfundimtare dhe raportit mbi afarizëm nga Bordi i Drejtorëve.

Neni 21

Mbi përdorimin e fitimit të realizuar dhe mbulimin e humbjeve vendos Bordi i Drejtorëve, në pajtim me ligjin dhe këtë Statut.

Neni 22

Fitimi i realizuar i takon themeluesit të shoqërisë.

Neni 23

Themeluesi ka të drejtë që në tërësi ta tërheq fitimin e realizuar, si dhe në tërësi apo pjesërisht të ri-investojë, gjegjësisht të bëjë de-kapitalizimin në Shoqëri pas përfundimit të vitit afarist.

Neni 24

Nëse Shoqëria përfundon vitin afarist me humbje, ajo kompensohet nga fitimi i Shoqërisë, nëse një fitim i tillë ekziston.

Nëse Shoqëria nuk ka fitim të realizuar, humbjet kompensohen nga kapitali themeltar që përcaktohet me vendim me rastin e aprovimit të llogarisë përfundimtare, në të cilin rast ajo humbje është paraqitur.

Nëse Shoqëria sipas llogarisë vjetore paraqet humbje, ajo do të mbulohet nga burimet e përcaktuara me dispozitat në fuqi.

Neni 25

Shpenzimet e punës dhe afarizmit të Shoqërisë mbulohen nga mjetet në llogarinë rrjedhëse.

Neni 26

Themeluesi bart rrezikun për afarizëm të Shoqërisë me të gjithë pasurinë që ka.

Neni 27

Organet e Shoqërisë

Shoqëria ka këto organe: Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore të Aksionarëve dhe Bordin e Drejtorëve si organ jo-ekzekutiv afarist dhe Menaxhmentin Ekzekutiv.

Neni 28

Mbledhja e Aksionarëve sipas urdhrit të Gjykatës

Nëse mbledhja vjetore e aksionarëve nuk mbahet brenda 6 muajve të parë pas përfundimit të vitit financiar të shoqërisë, ose katërmëdhjetë (14) muaj pas mbledhjes së fundit vjetore të aksionarëve (ose dymbëdhjetë [12] muaj pas regjistrimit fillestar të shoqërisë, nëse nuk është mbajtur ndonjë mbledhje e mëhershme), gjykata kompetente mund të nxjerrë vendim për mbajtjen e mbledhjes pas kërkesës së cilitdo drejtor ose cilitdo aksionar, i cili ka të drejtë pjesëmarrjeje dhe vote në mbledhjen në fjalë.

Nëse mbledhja e jashtëzakonshme nuk mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas dorëzimit të kërkesës sipas dispozitave të këtij Statuti, ose datës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes, gjykata mund të nxjerrë vendim për mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme pas kërkesës së cilitdo aksionar që ka nënshkruar kërkesën.

Gjykata mund të nxjerrë vendime të tjera përkatëse të nevojshme për arritjen e qëllimit të mbledhjes, duke përfshirë edhe vendimin për mbajtjen dhe emërimin e personave që do të kryesojnë mbledhjen nëse Bordi refuzon të bëjë këtë, ose vendime mbi vendin dhe kohën e mbajtjes së mbledhjes, caktimin e datës për përcaktimin e aksionarëve që kanë të drejtë vote, ose të përcaktojë formularin dhe përmbajtjen e njoftimit të mbledhjes.

Neni 29

Bordi i Drejtorëve

1. Biznesi dhe detyrat e Kompanisë do të drejtohen nga Bordi i Drejtorëve, siç është përcaktuar në këtë Statut dhe ligj.
2. Bordi i Drejtorëve i NPQ "Posta e Kosovës" Sh.A sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 03/253 të datës 21.03.2025, ka këtë përbërje:

2.1. Gëzim Paci – Kryesues;

2.2. Safija Beseni – Anëtare;

2.3. Sebahate Rexha – Anëtare;

2.4. Visar Nura – Anëtar;

2.5. Nora Rraci - Anëtare e Bordit të Drejtorëve sipas detyrës zyrtare nga Pozita e Kryeshefit Ekzekutiv.

3. Bordi i Drejtorëve duhet që sipas përgjegjësive të tij kolektive:

3.1. Të respektojë Statutin e kompanisë dhe aktet ligjore dhe të zbatojë vendimet e Mbledhjes së Përgjithshme, në pajtueshmëri me ligjin;

3.2. Të përcaktojë dhe rregullisht – së paku çdo tre muaj – të rishikojë strategjinë e kompanisë;

3.3. Të përgatisë dhe miratojë strategjinë afatgjate, investimet dhe planet financiare të kompanisë dhe – brenda afatit relevant kohor – ta rishikojë atë kurdo që është e nevojshme, së paku çdo tre muaj të bëjë ndryshime, të cilat mund të jenë të nevojshme;

3.4. Në bazë të këtyre planeve afatgjate, të nxjerrë direktiva strategjike për KSHE kurdo që është e nevojshme;

3.5. Të miratojë planin vjetor të biznesit dhe buxhetin vjetor të përgatitur nga KSHE në bazë të planit të tillë afatgjatë;

3.6. Të emërojë, largojë apo zëvendësojë KE, të përcaktojë me propozim të Komisionit të Auditimit – kompensimin e tij ose saj, si dhe të sigurojë që procesi për përzgjedhjen e KE-së do të organizohet në mënyrë transparente dhe të arsyeshme, në këtë mënyrë t'i sigurojë kompanisë disponueshmërinë e talenteve dhe kompetencave adekuate;

3.7. Të përcaktojë transaksionet në bazë të të cilave KSHE nuk do të ketë fuqinë të veprojë (dhe të obligojë kompaninë) në mënyrë të pavarur dhe duhet të kërkojë autorizim paraprak nga Bordi i Drejtorëve, apo nënshkrimin e përbashkët të ndonjë zyrtari tjetër;

3.8. Të emërojë me propozim të KE-së dhe të largojë apo zëvendësojë ZKF dhe Sekretarin, si dhe të përcaktojë në bazë të propozimit të Komisionit të Auditimit- kompensimin e tyre;

3.9. Të përcaktojë me propozim të KE-së transaksionet financiare në bazë të të cilave ZKF nuk do të ketë fuqinë të veprojë (dhe të obligojë kompaninë) në mënyrë të pavarur dhe do të duhet të kërkojë autorizim paraprak nga KSHE apo nga Bordi i Drejtorëve;

3.10. Të kryejë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze mbi punën e biznesit të kompanisë, mbi punën e KSHE, KZF dhe sekretarit, mbi organizimin e brendshëm të kompanisë dhe mbi performancën e kompanisë, dhe të sigurojë që linjat e raportimit të kompanisë janë të organizuara për të lejuar performancën e duhur të një detyre të tillë të mbikëqyrjes; dhe, mbi këto baza, të zbatojë këto detyra të besuara të zyrtarëve (në rastin e Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm vetëm me propozim të Komisionit të Auditimit);

3.11. Të miratojë në fund të secilit vit të biznesit, pa kurrfarë vonese dhe në çfarëdo rasti brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pas përfundimit të vitit financiar të kompanisë:

3.11.1 bilancin vjetor dhe pasqyrën e fitimit dhe humbjeve të kompanisë dhe çfarëdo pasqyre tjetër financiare që kërkohet me ligj;

3.11.2. një raport vjetor në menaxhim, rregullore të biznesit, gjendjen financiare dhe industriale të kompanisë, i cili do të duhet të përfshijë vështrimet e saja në atë mënyrë që operacionet dhe performanca e kompanisë mund të barazohen me planet afatgjata. Gjithashtu të paraqes propozimin e saj për alokim, investim apo shpërndarje të fitimit vjetor, apo mbulimin e humbjeve; dhe

3.11.3. një deklaratë për aksionarët që sipas njohurive më të mira të Bordit të Drejtorëve, duke marrë parasysh raportin e Komisionit të Auditimit, si dhe sipas hetimit të vet të pavarur dhe të kujdesshëm dhe konsolidimit adekuat, dokumentet e lartpërmendura janë të vërteta, të drejta dhe të sakta, dhe ato nuk lënë pa përmendur asnjë informatë apo pasqyrë, mos përfshirja e të cilave do të konsiderohej si lajthitje, dhe ato t'i dorëzojë, së bashku me raportin nga auditori i jashtëm në dokumentet e parashtruara tek aksionarët së paku tridhjetë (30) ditë para datës së Mbledhjes së Përgjithshme Vjetore;

3.12 Të sigurojë që sistemet adekuate të Kontrollit të Brendshëm, duke përfshirë kontrollin financiar dhe procedurat, janë në vendin e duhur;

3.13 Të sigurojë që sistemet dhe procedurat adekuate janë në vendin e duhur për të garantuar se librat dhe regjistrat e kompanisë, duke përfshirë regjistrat financiarë, mbahen në pajtueshmëri me standardet e kontabilitetit dhe ligjeve në fuqi dhe se draft raportet financiare vjetore janë të përgatitura si duhet;

3.14 Të sigurojë që auditimi i librave dhe regjistrave kryhet të paktën çdo vit nga auditori i jashtëm;

3.15 Të sigurojë që sistemet dhe procedurat adekuate janë vendosur për të garantuar se kompania i respekton të gjitha ligjet e aplikueshme gjatë kryerjes së biznesit dhe detyrave;

3.16 Të identifikojë, me kërkesë të KE-së, shenjat adekuate në mënyrë që të matet rregullisht performanca e kompanisë; dhe

3.17 Të sigurojë që biznesi i kompanisë kurrë nuk devijon nga qëllimi i deklaruar në Statut, pa autorizimin e qartë të Mbledhjes së Përgjithshme;

3.18 Bordi i Drejtorëve mund, përveç kësaj, të nxjerrë direktiva për KSHE në organizimin e brendshëm të kompanisë dhe alokimin e fuqisë dhe autoritetin vendimmarrës së bashku me zyrtarët dhe menaxherët e kompanisë, si dhe me propozim të KSHE-së, mund të caktojë zyrtarë të tjerë (përveç KSHE, KZF, Sekretarit dhe Zyrtarit për Auditim të Brendshëm), duke vendosur

fuqitë, detyrat dhe rregullat e tyre në lidhje me emërimin, kompensimin, largimin apo zëvendësimin e tyre.

Neni 30 **Kompetencat e Bordit të Drejtorëve**

Bordi i Drejtorëve ka këto kompetenca:

- marrja e vendimeve mbi të gjitha çështjet, përveç vendimeve që u janë rezervuar aksionarëve me ligj apo këtë Statut;
- miratimi i planeve afariste strategjike të Shoqërisë;
- konvokimi i mbledhjeve vjetore dhe të jashtëzakonshme të aksionarëve;
- përgatitja e agjendës fillestare të mbledhjes së aksionarëve;
- përcaktimi i datës për listën e aksionarëve që kanë të drejtë të marrin pjesë në mbledhjen e aksionarëve;
- emetimi i aksioneve brenda kufizimeve të parapara në këtë Statut;
- mundësia për blerjen e aksioneve apo letrave me vlerë;
- punësimi i zyrtarëve;
- vendosja e shpërblimit dhe kushtet tjera të marrëveshjes me auditorin e shoqërisë;
- përcaktimi i shumave dhe caktimi i datave të pagesës dhe procedurat për pagesën e dividendëve;
- miratimi i Raportit Vjetor të shoqërisë dhe vlerësimi vjetor i fitimit dhe humbjeve, të cilat pastaj dorëzohen tek aksionarët për miratim;
- si dhe vendosja për të gjitha çështjet tjera që kanë të bëjnë me kompetencën ekskluzive të Bordit të Drejtorëve të përcaktuar me këtë Statut.

Neni 31 **Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve**

1. Bordi i Drejtorëve mban mbledhje të rregullt, apo kurdo që paraqitet nevoja nga ana e udhëheqësit apo nga dy (2) apo më shumë drejtorë. Njoftimi për mbledhjen duhet të ketë agjendën dhe duhet të dorëzohet me dorë së paku tri ditë para mbledhjes, me faks apo e-mail apo me çfarëdo mënyre tjetër, të cilat sigurojnë pranimin me kohë. Në raste të emergjencës, njoftimi për mbledhjen duhet të përcillet me letër dhe të dërgohet me dorë, me faks apo e-mail së paku një ditë para mbledhjes.

2. Në mbledhje, udhëheqësi i Bordit të Drejtorëve, duke vepruar arsyeshëm dhe në pajtueshmëri me ligjin dhe këto statute, duhet të përcaktojë praninë e kuorumit, të drejtojë debatin, të mbajë procesverbalin, si dhe të përcaktojë dhe deklarojë rezultatet e votimit. Sekretari do të asistojë udhëheqësin, përveç nëse çështja e konfidencialitetit kërkon që drejtori të veprojë si Sekretar i Mbledhjes.

3. Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve përbëhen në mënyrë valide me prezencën e shumicës së drejtorëve në zyrë dhe duhet të veprojë me votën pohuese të shumicës së drejtorëve pjesëmarrës në mbledhje.

Drejtorët, të cilët mund të abstenojnë nga votimi dhe drejtorët, të cilët kanë shpalosur konflikt interesash, nuk do të përfshihen në numërim në lidhje me shumicën. Në rast barazimi me vota, udhëheqësi i Bordit të Drejtorëve duhet të ketë votën vendimtare.

4. Nëse, për shkak të boshllëkut, numri i drejtorëve është më i vogël se numri i vendosur si kuorum, drejtorët e mbetur (apo drejtori) mund të veprojnë vetëm për qëllim të thirrjes së Mbledhjes së Përgjithshme për plotësimin e vendeve të lira.

5. Mbledhja e Bordit të Drejtorëve mund të mbahet në më shumë se një lokacion, me lidhje të dyanshme përmes zërit apo video-konferencës, përderisa kërkesat e parashtuara janë përmbushur dhe janë arsyetuar në procesverbal:

5.1. Udhëheqësi i Mbledhjes duhet të jetë në gjendje të përcaktojë identitetin dhe të drejtën e pjesëmarrjes së atyre që janë prezent, të udhëheq mbledhjen, si dhe të konstatojë dhe deklarojë rezultatet e votimit;

5.2. Sekretari i Mbledhjes duhet të jetë në gjendje të perceptojë ngjarjet në mënyrë adekuate gjatë mbledhjes;

5.3. Pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në diskutime dhe të votojnë për pikat e agjendës, gjithashtu edhe të lexojnë, të pranojnë apo të dërgojnë dokumente që ndërlidhen aty (nëse ka);

6. Vendimi me shkrim, i nënshkruar nga shumica e drejtorëve në zyrë, do të ketë të njëjtën fuqi dhe efekt sikurse vendimi që ka kaluar në mbledhjen e Drejtorëve të Bordit që është thirrur dhe mbajtur. Çfarëdo vendimi i tillë mund të përbëhet prej disa dokumenteve që kanë formë dhe përmbajtje identike, secili i nënshkruar nga një apo më shumë drejtorë.

Neni 32 Komisioni i Auditimit

Komisioni i Auditimit duhet të formohet dhe të ketë fuqitë siç janë të përcaktuara në Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike.

Neni 33 Zyrtarët

Zyrtarët e kompanisë

Zyrtarët e kompanisë do të jenë Kryeshefi Ekzekutiv, Zyrtari Kryesor Financiar, Zyrtari i Auditimit të Brendshëm, Sekretari dhe zyrtarë të tjerë të caktuar nga Bordi i Drejtorëve.

1. Kryeshefi Ekzekutiv

1.1. Kryeshefi Ekzekutiv i kompanisë (KSHE) do të ketë autoritet për të lidhur kontratë për kompaninë, në pajtueshmëri me Statutin, me këto akte ligjore dhe ligjin, duke iu nënshtruar vetëm kufizimeve të përcaktuara nga Bordi i Drejtorëve sipas nenit 3 (pika 4)(g).

1.2. Biznesi, detyrat dhe organizimi i kompanisë duhet të kryhen sipas direktivave, mbikëqyrjes dhe përgjegjësinë së KSHE-së, në pajtueshmëri me Statutin dhe aktet ligjore të kompanisë dhe vendimeve të Bordit të Drejtorëve. Të gjitha çështjet në lidhje me biznesin e kompanisë, të cilat nuk janë përgjegjësi të Mbledhjes së Përgjithshme, të Bordit të Drejtorëve, Komisionit të Auditimit apo Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm, do të vendosen nga/apo sipas direktivave dhe përgjegjësisë së KSHE-së.

1.3. KSHE do të ketë autoritet të punësojë apo të largojë nga puna zyrtarët dhe stafin e kompanisë, si dhe të delegojë autoritetin e tillë tek zyrtarët e tjerë dhe anëtarët e tjerë, përfshirë edhe:

1.3.1. Kryezyrtarin Financiar

1.3.2. Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm

1.3.3. Sekretarin dhe

1.3.4. cilindo zyrtar tjetër që Bordi i Drejtorëve në mënyrë specifike mban të drejtat të punësojë apo të largojë.

1.4. KSHE gjithashtu duhet:

1.4.1. Të këshillojë dhe asistojë Bordin e Drejtorëve në përcaktimin e strategjisë së kompanisë, si dhe planet e saja strategjike afatgjata;

1.4.2. Të propozojë Bordit të Drejtorëve kandidat të përshtatshëm për punësim si KZF dhe Sekretarë, duke sugjeruar së paku dy (2) persona për secilën pozitë;

1.4.3. Të dorëzojë, sipas përgjegjësisë së tij, Bordit të Drejtorëve drafte të dokumenteve që parashikohen sipas nenit 3 (pika 4)(k)(i) dhe nenit 3 (pika 4)(k)(ii);

1.4.4. T'i ofrojë kurdo që të jetë e nevojshme dhe së paku një herë në tre muaj, Bordit të Drejtorëve raporte për transaksionet kryesore të ndërmarra nga kompania dhe për vendimet kryesore të ndërmarra nga Menaxhmenti në lidhje me udhëheqjen e biznesit dhe punëve të kompanisë;

1.4.5. T'i dorëzojë, nën përgjegjësinë e tij/saj, Bordit të Drejtorëve dokumente, letra dhe informacione në lidhje me të gjitha çështjet e përfshira në agjendën e mbledhjeve të tij;

1.4.6. T'i propozojë Bordit të Drejtorëve shenja adekuate për matjen e performancës së kompanisë, si dhe t'i ofrojë Bordit rregullisht, së paku çdo tre muaj, raportet e matjes së performancës së kompanisë kundrejt shenjave të tilla;

1.4.7. Të themelojë dhe rishikojë strukturën organizative të kompanisë, alokimin e fuqisë vendimmarrëse të kompanisë, si dhe të fuqisë të ndërlidhjes në mes të udhëheqësve dhe të të punësuarve në kompani;

1.4.8. T'i ofrojë Komisionit të Auditimit të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkohet;

1.4.9. T'i ofrojë Zyrtarit të Auditimit të Brendshëm të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkohet nga ky i fundit; dhe

1.4.10. Të merr pjesë në të gjitha Mbledhjet e Përgjithshme.

2. Zyrtari Kryesor Financiar

1. Zyrtari Kryesor Financiar i Kompanisë ("ZKF") do të menaxhojë, nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e KSHE-së, çështjet financiare të kompanisë. Varësisht prej kufizimeve të vëna nga Këshilli i Drejtorëve, do të ketë autoritetin e lidhjes së të gjitha kontratave financiare për kompaninë dhe do të jetë përgjegjës që:

1.1. Të mirëmbajë llogaritë e kompanisë të azhurnuara dhe të sakta;

Të themelojë dhe udhëheq të gjitha kontrollet e brendshme financiare, duke përfshirë blerjet, pranimet e parave të gatshme dhe pasuritë themelore. Të monitorojë llogaritë e pagueshme dhe të koordinojë pagesën e faturave dhe blerjet speciale. Të rishikojë shpenzimet e të punësuarve për të siguruar pajtueshmërinë me politikën e korporatës dhe buxhetin para pagesës së tyre;

1.2. Të përgatisë të dhënët e kompanisë për auditim në fund të vitit;

1.3. Të rishikojë, të arrijë marrëveshje për prokurime dhe mirëmbajtje të të gjitha bizneseve të ndërlidhura me politikën e sigurimit;

1.4. Të koordinojë funksionet tjera të biznesit, siç janë dhënia me qira e objekteve dhe pajisjeve, si dhe të bëjë blerje me KSHE dhe zyrën apo funksionin e prokurimit të kompanisë;

1.5. Të menaxhojë thesarin e kompanisë;

1.6. Të vendos dhe përgatitë buxhetet; dhe

1.7. Çfarëdo tjetër detyre e përcaktuar nga ana e KSHE-së.

3. Zyrtari i Auditimit të Brendshëm

1. Nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Komisionit të Auditimit dhe duke i raportuar ekskluzivisht atij, Zyrtari i Auditimit të brendshëm të kompanisë ("Zyrtari i Auditimit të Brendshëm ") do të jetë përgjegjës për:

1.1. Udhëheqjen, menaxhimin dhe organizimin e brendshëm të Zyrës së Auditimit, duke zgjedhur stafin e vet;

1.2. Udhëheqjen dhe drejtimin e të gjitha aktiviteteve të auditimit të brendshëm; dhe

1.3. Përbushjen e çfarëdo detyre tjetër të përcaktuar nga ana e Komisionit të Auditimit.

4. Sekretari

1. Sekretari i kompanisë ("Sekretari"):

1.1. Do të mirëmbajë regjistrin e aksionarëve;

1.2. Do të veprojë si agjent i kompanisë për pranimin e njoftimeve;

1.3. Do të kryejë të gjitha arkivimet, publikimet dhe/ose zbulimet për autoritetet përkatëse siç mund të kërkohet me ligj ose nga këto statute;

1.4. Do të mbikëqyrë mirëmbajtjen e duhur dhe azhurnimin e rregullt të ueb faqes, siç parashihet me nenin 8 (pika 6); dhe

1.5. Do të koordinojë me KSHE-në përgatitjen e letrave (dokumenteve) për mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve.

2. Sekretari do të mbajë procesverbalin e secilës Mbledhje të Përgjithshme, Bordit të Drejtorëve dhe Komisionit të Auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesi i tyre), dhe do t'i shënojë ato në librat e protokolleve. Procesverbali do të përmbajë këto informata: emrat e personave pjesëmarrës, vendin dhe kohën e mbledhjes, çështjet kryesore të ngritura gjatë diskutimit të pikave të veçanta të agjendës, tekstin e vendimeve të propozuara, rezultatin e secilit votim dhe të votave të secilit individ (pjesëmarrës), tekstin e saktë të vendimeve të arritura, si dhe çfarëdo kundërshtimi i ngritur në lidhje me vendimet e vendosura.

3. Procesverbali për Mbledhjet e Përgjithshme do të nënshkruhet nga kryesuesi i Mbledhjes së Përgjithshme dhe nga Sekretari dhe do të dorëzohet për aprovim në Mbledhjen e ardhshme të Përgjithshme. Sekretari do të lëshojë kopje të certifikuara të procesverbalit. Procesverbali i Mbledhjes së Përgjithshme do t'iu vihet aksionarëve në dispozicion me kërkesën me shkrim.

4. Procesverbali i secilës mbledhje të Bordit të Drejtorëve do të dorëzohet për aprovim në mbledhjen e ardhshme të Bordit të Drejtorëve. Procesverbali i secilës mbledhje të Bordit të Drejtorëve do të nënshkruhet nga ana e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve dhe do t'iu shpërndahet anëtarëve të Bordit të Drejtorëve. Të njëjtat rregulla do të zbatohen për procesverbalet e Komisionit të Auditimit.

Neni 34

Detyrat e besuara

1. Çdo drejtor dhe zyrtar do të ketë detyra të lëna në mirëbesim për kompaninë, në përputhje me ligjin. Këto detyra në mirëbesim gjithmonë do përfshijnë detyrat që:

1.1. Të veprojnë në besim të mirë ekskluzivisht për përfitime kolektive dhe për përfitime objektive të aksionarëve, gjithmonë në përputhje me ligjin dhe Statutin;

1.2. Të ushtrojnë fuqinë që iu është dhënë atyre ekskluzivisht në përputhje me interesat më të mira kolektive dhe objektive të aksionarëve;

1.3. Të kenë konsideratë adekuate për çështjet që duhet vendosur nga ata dhe të sigurojnë të gjitha informatat e nevojshme për marrjen e vendimeve të tilla, duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë e tyre;

1.4. Të shmangin dhe shpalosin konfliktet e tanishme dhe potenciale në mes të interesave të tyre personale (direkte apo indirekte) dhe të interesave të kompanisë;

1.5. Të ushtrojnë kujdes të arsyeshëm, zell dhe aftësi gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre; dhe

1.5. Të trajtojnë si konfidenciale të gjitha informatat të pranuar me arsye nga zyra e tyre ose gjatë zbatimit të detyrave të tyre.

Neni 35

Veprimet e Bordit pa mbajtjen e mbledhjes

Përveç nëse me Statut ose rregullore të shoqërisë kërkohet që një aktivitet i Bordit të ndërmerret ekskluzivisht në mbledhje të Bordit, të gjitha aktivitetet, të cilat mund të ndërmerren në mbledhjet e Bordit, mund të ndërmerren edhe pa mbajtjen e mbledhjes, nëse pëlqimi me shkrim që përmban edhe natyrën e aktivitetit përkatës nënshkruhet nga të gjithë drejtorët me të drejtë vote për atë çështje. Të gjitha këto pëlqime duhet të përmbahen në një ose më shumë miratime me shkrim, të cilat duhet të paraqesin aktivitetin e ndërmarrë, si dhe të kenë nënshkrimin e një ose më shumë drejtorëve. Të gjitha këto pëlqime duhet të vendosen në procesverbalin nga mbledhja e Bordit të Drejtorëve të shoqërisë. Pëlqimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga të gjithë drejtorët, përveç nëse në pëlqim është caktuar një datë tjetër e hyrjes në fuqi.

Neni 36

Komisionet e Bordit

1. Bordi i Drejtorëve, me rregulloren e tij të brendshme, përcakton kur mund të miratohet themelimi i një ose më shumë komisioneve (komisioni për auditim ose për shqyrtimin e kompensimeve) që do të shqyrtojnë, hulumtojnë, rekomandojnë ose marrin masa të tjera jo-obligative, të cilat janë në kuadër të kompetencës së Bordit.

2. Këto komisione mund të përfshijnë edhe anëtarët e Bordit të Drejtorëve dhe punëtorët e shoqërisë, si dhe persona jashtë kompanisë, sipas përcaktimit në rregullore.

3. Miratimi i rregulloreve nga Komisionet e Bordit kërkon shumicën e anëtarëve të komisionit që përbëjnë kuorumin dhe shumica e kuorumit është e nevojshme për çdo rekomandim ose veprim

tjetër të komisionit. Të gjitha vendimet dhe veprimet e tjera të komisionit i nënshtrohen rishikimit, ndryshimit dhe miratimit me jo më pak se 2/3 e anëtarëve të Bordit.

Neni 37 Shpalosjet

1. Raportet e Bordit të Drejtorëve

Pas çdo takimi të Bordit të Drejtorëve, kjo e fundit do të lëshojë një raport të shkurtë në një gjuhë të qartë, duke vënë në pah një përmbledhje të vendimeve më të rëndësishme dhe rezolutave të arritura në mbledhje, duke i fshehur vetëm ato informata në lidhje me të cilat nevojitet konfidencialitet i arsyeshëm; informata të tilla do të përfshihen në raportet e mëvonshme kur më nuk ekziston nevoja për të ruajtur konfidencialitetin.

2. Konflikti i Interesave

Bordi i Drejtorëve dhe Komisioni i Auditimit rregullisht, së paku çdo tre muaj, do të lëshojnë një raport të shkurtër e të përbashkët, me një gjuhë të qartë që nxjerr në pah të gjitha rastet në të cilat cilido drejtor apo zyrtar ka deklaruar ekzistimin e konfliktit potencial të interesave dhe ka abstenuar nga votimi ose nga veprimi, duke dhënë indikacione për natyrën e interesave dhe vendimet vepruese për shkak të të cilave janë ngritur ato. Një pjesë e informatave të tilla mund të mbahet nëse çështja e arsyeshme kërkon që konfidencialiteti të respektohet për shkak të kompanisë. Informatat e tilla do të përfshihen në raportet e mëvonshme kur më nuk ekziston nevoja për konfidencialitet; në asnjë rrethanë informacioni nuk mund të mbahet për shkak të interesave të drejtorit apo zyrtarit përkatës.

3. Transaksionet me palët e ndërlidhura

Komisioni i Auditimit rregullisht – së paku çdo tre muaj - do të lëshojë një raport të shkurtë dhe me një gjuhë të qartë, duke nxjerr në pah transaksionet më të rëndësishme me palët e ndërlidhura, të cilat nuk i ka miratuar, duke dhënë arsyet për mos-miratimin e tyre, dhe të gjitha transaksionet me palët e ndërlidhura që i ka miratuar, duke paraqitur vlerën e transaksioneve; vlerën e bilanceve të papaguara, duke përfshirë kushtet, konditat dhe garancitë; provizionet për borxhet e dyshimta lidhur me vlerën e bilanceve të papaguara dhe shpenzimet e pranuar gjatë periudhës në lidhje me borxhet e këqija (të pa-pagueshme) apo të dyshimta të caktuara nga palët përkatëse të ndërlidhura, si dhe deklaratën se kjo e fundit ka qenë e arsyeshme dhe e drejtë për kompaninë. Një pjesë e informatave të tilla mund të mbahet nëse çështja e arsyeshme kërkon që konfidencialiteti të respektohet për shkak të kompanisë. Informatat e tilla do të përfshihen në raportet e mëvonshme kur më nuk ekziston nevoja për konfidencialitet; në asnjë rrethanë informacioni nuk mund të mbahet për shkak të interesave të palës përkatëse të ndërlidhur.

4. Faqja Zyrtare (ueb faqja)

1. Kompania do të krijojë dhe në mënyrë të rregullt do të azhurnojë, nën përgjegjësinë e KSHE-së, një ueb faqe, ku do të paraqiten së paku këto informacione:

1.1. Dokumentet zyrtare që parashihen dhe raporti për dokumentet e tilla nga Komisioni i Auditimit;

1.2. Raporti nga auditori i jashtëm për pasqyrat financiare që parashihen me LNP;

1.3. Lista e kontratave më të rëndësishme të prokurimit që janë lidhur gjatë vitit aktual financiar, që tregojnë natyrën e tyre, çmimin dhe palët tjera, pa paragjykim të çfarëdo obligimi të konfidencialitetit që i obligohet të fundit. Atëherë kur kompania do të veprojë në një treg garues, ajo mund të fshijë të dhënat e ndjeshme komerciale në lidhje me çmimet nga shpalosjet e tilla;

1.4. Lista e të gjitha kontratave të prokurimit të lidhura gjatë vitit aktual financiar pa ndjekur procedurat e tenderimit, duke treguar për natyrën e tyre, çmimin, palët tjera (pa paragjykim të çfarëdo obligimi të konfidencialitetit që i obligohet këtij të fundit) dhe arsyen pse procedurat e tenderimit nuk janë përcjell;

1.5. Lista e dhjetë (10) furnizuesve më të rëndësishëm të kompanisë, me çmimet e furnizimeve;

1.6. Çfarëdo padie në gjyq apo rastet në pritje në lidhje me vlefshmërinë e çfarëdo zgjedhjeje të drejtorit, shkelje të detyrave të mirëbesimit të drejtorëve apo zyrtarëve apo vlefshmëria e çfarëdo vendimi të miratuar nga ana e Bordit të Drejtorëve;

Të gjitha informatat dhe dokumentet e tilla do të shpërndahen në paragrafë të ndarë dhe në mënyrë të lehtë për tu qasur, me lidhje tek dokumentet tjera kurdo që të jetë e nevojshme, dhe do të përfshihet në një paragrafë të vetëm të ueb faqes, e cila i dedikohet shpalosjeve publike për çështjet e korporatës, dhe do të vendosët në një mënyrë të thjeshtë që mund të lexohet lehtë, e secila nga këto në një format që mund të printohet lehtë.

Neni 38

Detyrimi për mos Konkurrencë

Kryesuesi i Bordit, drejtorët tjerë, si dhe anëtarët e Shoqërisë nuk mund direkt apo indirekt, të rregullt apo përkohësisht, për llogari të vet apo tjetërkujt, të kryejnë punë në shoqëritë tjera tregtare apo të tjera, të cilat punë Shoqëria i ka të parapara në veprimtarinë e vet. Po ashtu ata nuk guxojnë të kenë aksione tjera në shoqëritë tjera dhe as të jenë anëtarë të shoqërive të tilla, në qoftë se atë veprimtari paraprakisht nuk ia lejon aksionari.

Neni 39

Nëse anëtari i shoqërisë vepron në kundërshtim me nenin paraprak, shoqëria mundet të kërkojë kompensimin e dëmit të shkaktuar.

Neni 40

Rezervat dhe Pasuria e Shoqërisë

Shoqëria është e obliguar që të krijojë rezervat obligative. Mbi formimin e rezervave obligative kujdeset Bordi i Drejtorëve.

Vendimin për rezerva tjera eventuale të Shoqërisë, të cilat do të formoheshin me ndarjen nga fitimi, e nxjerrë Kuvendi, nëse vlerëson që rezervat e tilla janë të nevojshme.

Neni 41

Pasurinë e përbëjnë: e drejta e pronësisë në sendet e luajtshme dhe të paluajtshme, mjetet financiare dhe letrat me vlerë, si dhe të drejtat e tjera pronësore.

Neni 42

Të Punësuarit

Vendimet mbi pranimin dhe ndërprerjen e angazhimit të zyrtarëve të lartë të kompanisë i merr Bordi i Drejtorëve, ndërsa për punonjësit tjerë Kryeshefi Ekzekutiv i shoqërisë.

Në qeverisjen e Shoqërisë, pjesëmarrjen në fitim dhe realizimin e të drejtave tjera nga marrëdhënia e punës, të punësuarit i gëzojnë të drejtat e përcaktuara me ligj dhe aktet normative të Shoqërisë.

Neni 43

Shpërbërja e Shoqërisë

Shoqëria është themeluar për kohë të pacaktuar dhe mund të shpërbëhet vetëm në rastet dhe mënyrën e përcaktuar me ligj dhe këtë Statut.

Neni 44

Themeluesi vendos mbi shpërbërjen. Vendimi nxirret në formë të dokumentit të shkruar publik. Në atë rast zhvillohet procedura e përcaktuar e likuidimit.

Neni 45

Dispozitat përfundimtare

Kohëzgjatja e kësaj Shoqërie nuk është e kufizuar në kohë. Ajo është themeluar për kohë të pacaktuar.

Neni 46

Aktet e përgjithshme të Shoqërisë duhet të jenë në harmoni me këtë Statut.

Neni 47

Shoqëria mundet ta ndërrojë emërtimin, selinë dhe veprimtarinë me Vendim të Shoqërisë në formë të shkruar.

Neni 48

Dispozita të përgjithshme

Për çfarë nuk është shprehur në Statut, referimi bëhet në Ligjin Nr. 03/L-087 "Për Ndërmarrjet Publike" dhe Ligjit Nr. 06/L-016 "Për Shoqëritë Tregtare" të Republikës së Kosovës.

Neni 49

Hyrja në fuqi

Ky Statut hyjë në fuqi në datën e miratuar nga ana e Bordit të Drejtorëve të Postës së Kosovës Sh.A. dhe shfuqizon Statutin e NQP Posta e Kosovës Sh. A me nr.01-2588/24 i datës 25.11.2024.

Kryesues i Bordit të Drejtorëve

Gëzim Padi

